

**OPERATORI I SISTEMIT TË TRANSMETIMIT**  
**DEPARTAMENTI I FINANCËS**  
**DREJTORIA EKONOMIKE**

Nr. 6954 prot.

Tiranë, më 02.12.2021

Lënda: Përgjigje shkresës Nr.914/4, datë 26.11.2021 “Kërkesë për informacion”.

**ENTIT RREGULLATOR TË ENERGJISË** ✓  
Blvd. “Bajram Curri”, Rr. Viktor Eftimiu 1023, Tiranë

I nderuar Z. Ahmeti,

Në përgjigje të shkresës suaj Nr.914/4, datë 26.11.2021 “Kërkesë për informacion”, lutem gjeni informacionin e kërkuar si mëposhtë vijon:

1. *Tabelat e shpenzimeve dhe të ardhurave të realizuara për Vitin 2020 dhe 9-mujorin 2021 dhe parashikimet për periudhën tetor-dhjetor 2021 dhe periudhën 2022-2024 të paraqiten në formë analitike për secilin zë, të shoqëruara me arsyetimet, argumentimet përkatëse si dhe dokumentacion justifikues (dokumentacioni mund të nisët i skanuar ose në çdo formë tjetër që shoqëria e konsideron më të arsyeshme).*

Në lidhje me këtë çështje, ju sqarojmë se në materialet e derguara me tonën Nr. 5215/3 datë 04.11.2021, konkretisht: (i) Pasqyrat Financiare dhe Shenimet shpjeguese për vitin 2020; (ii) në materialin “Raporti i aktivitetit të OST sh.a. Janar-Shtator 2021 dhe Parashikimi i Vitit 2021”, janë paraqitur në mënyrë analitike realizimi faktik dhe parashikimet për të gjithë zërat e treguesve të shoqërisë për vitin 2020 dhe 2021.

Gjithashtu, në materialin e dërguar me tonën Nr. 5215 datë 31.08.2021, konkretisht në “Relacionin për llogaritjen e tarifave të transmetimit të energjisë elektrike për vitin 2022 dhe periudhën 2022-2024”-faqe 39-44, janë paraqitur në mënyrë analitike parashikimet për secilin nga zërat e treguesve të shoqërisë për vitin 2022. Në materialet e dërguara pranë ERE, janë analizuar dhe janë dhënë sqarimet përkatëse dhe për vlerësimet e treguesve për vitet 2023 dhe 2024 (Shresa Nr. 5215/3 datë 04.11.2021), të cilët janë parashikuar duke marrë në konsideratë realizimet historike të tyre si dhe vlerësimet më të fundit përse i përket çmimeve të energjisë në tregjet rajonale dhe ecurinë e tyre.

2. Nga analiza që i është bërë zërave të shpenzimeve të OPEX vihet re se për zërin "shpenzime personeli" për periudhën janar-shator 2021, kosto totale faktike e këtij shpenzimi është 946.3 milion lekë, ndërkohë që parashikimi juaj për këtë shpenzim deri në fund të vitit 2021 është 1,362 milion lekë.

Sa konstatuar, përcillni argumentat tuaj mbi diferencën e mbetur për tu realizuar për periudhën Tetor -Dhjetor 2021 në rritje me 100 milion lekë nga mesatarja e realizuar e këtij shpenzimi për 9 mujorin 2021.

Për Vitin 2022, gjithashtu parashikoni shpenzime personeli në një rritje të konsiderueshme krahasuar me Vitin 2021, të cilat duhet të argumentohen nga ana juaj. Për qëllime të vlerësimeve tona mbi këtë zë shpenzimi, dërgoni në ERE organigramën e plotë të shoqërisë së bashku me borderonë e pagave të muajit Tetor 2021 ku duhet të evidentohen niveli i pagave, trajtimeve financiare dhe çdo zë tjetër përbërës të shpenzimeve të personelit të ndarë për secilën nga kategoritë e punonjësve për aktivitetin e transmetimit dhe aktiviteteve të tjera të shoqërisë të cilat nuk janë të rregulluara.

Në lidhje me këtë çështje, ju sqarojmë se ecuria e kostove të personelit si dhe e zërave përbërës të tyre është dinamike dhe ndryshon nga muaji në muaj. Zëra të ndryshëm të kostove të personelit siç janë "shtesa turnesh dhe orë jashtë orari"; "udhëtime dhe dieta"; "shpenzime të tjera të personelit" kanë lidhje me dinamikën e ecurisë dhe problematikave të sistemit të transmetimit të cilat me ardhjen e stinës së dimrit pritet të jenë më të larta gjatë tremujorit të fundit të vitit. Gjithashtu, në tremujorin e fundit të vitit 2021, në përputhje me kontratën kolektive të punës si dhe në përputhje me parashikimet në programin e miratuar për vitin 2021, është parashikuar dhe paga e 13 për punonjësit e OST sh.a.. Përsa i përket shpenzimeve të personelit për vitin 2022, është parashikuar një rritje prej 2% e cila në vlerësimin tonë nuk mund të quhet e konsiderueshme. Vlerësimet për kostot e personelit janë bërë në përputhje me strukturën organizative të shoqërisë.

Në vijim të kërkesës suaj, bashkelidhur do të gjeni Organogramën e Plotë të Shoqërisë, e cila në tërësinë e saj, përmban strukturat e nevojshme për kryerjen e plotë të aktiviteteve të transmetimit.

Përsa i përket borderove të muajit Tetor 2021, në tabelën e mëposhtme paraqiten zërat e regjistruar të kostove të personelit sipas borderove përkatëse për secilën Njesi të OST sh.a.:

Muaji Tetor 2021	Njesia	NJMT	NJO-Tirana1	NJO-Elbasan	NJO-Fier	NJO-Korce	NJO-Burrel	NJO-Shkoder	Aparati Qendror	OT	OST
Fond per Pagat	Leke	3,863,047	7,550,539	4,509,334	6,196,572	2,961,381	3,897,000	7,624,381	26,843,784	643,095	64,089,133
Shtesa turni & Ore jashte orari	****	79,054	820,687	474,234	494,800	205,305	146,813	610,280	531,263	0	3,362,436
Ushqim Ditor	****	527,500	1,025,000	656,500	898,500	408,000	567,500	1,119,500	2,381,000	50,500	7,634,000
Udhetim dhe Dieta	****	91,460	0	0	0	7,800	27,500	434,000	1,180,654	0	1,741,414
Sigurime Shoqerore	****	818,680	1,713,154	1,039,449	1,390,316	650,077	837,484	1,712,182	4,287,530	106,120	12,554,992
Vjetersia ne Pune	****	487,400	938,234	633,724	785,000	366,500	446,700	953,200	2,681,714	67,200	7,359,672
Pensioni Vullnetar	****	100,200	352,080	131,120	344,960	179,540	212,020	166,900	1,887,272	64,500	3,438,592
Shpenzime te tjera Personeli	****	0	420,000	0	705,994	155,178	100,000	100,000	837,415	0	2,318,587
Shperblime	****	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
<b>Kosto Totale Personelit</b>	<b>Leke</b>	<b>5,967,341</b>	<b>12,819,694</b>	<b>7,444,361</b>	<b>10,816,142</b>	<b>4,933,781</b>	<b>6,235,017</b>	<b>12,720,443</b>	<b>40,630,632</b>	<b>931,415</b>	<b>102,498,826</b>
<b>Nr.Punonjësve</b>	<b>Nr</b>	<b>53</b>	<b>109</b>	<b>63</b>	<b>91</b>	<b>41</b>	<b>55</b>	<b>113</b>	<b>249</b>	<b>5</b>	<b>779</b>

3. Për zërin “materiale të para” shpenzimet faktike për periudhën janar-shator 2021 janë paraqitur në vlerën 63.1 milion lekë, ndërkohë që parashikimi juaj deri në fund të vitit 2021 është 118 milion lekë.

Gjithshtu konstatojmë se parashikimi juaj për Vitin 2022 dhe periudhën 2022-2024 krahasuar me realizimin e këtij shpenzimi për vitet 2020-2021 është kërkuar në rritje. Sa më sipër, paraqisni në formë analitike nënzërat për secilin grup të këtij shpenzimi duke argumentuar parashikimet tuaja për realizimin e tij për 3 mujorin e mbetur të vitit 2021 si dhe për periudhën 2022-2024 të shoqëruara me dokumentacion justifikues dhe për procedurat në proces që lidhen me këtë zë.

Në lidhje me këtë zë shpenzimesh, i cili përfshin: (i) “lëndën djegëse”, (ii) “kancelari”; (iii) “materiale të tjetra për njësitë” në funksion të ushtrimit të aktivitetit normal të OST sh.a., ju sqarojmë se parashikimet janë bërë duke marrë në konsideratë ecurinë historike të tyre si dhe rritjen e çmimeve të lëndës djegëse si pasoje e ndryshimit të çmimeve të energjise dhe karburanteve.

4. Për zërin “shërbime administrative e të tjera” paraqisni në mënyrë analitike realizimin e këtij zëri për Vitin 2020, periudhën janar-tetor 2021 krahas parashikimit për realizimin e tij deri në fund të vitit 2021 si për periudhën 2022-2024 të shoqëruar me dokumentajustificues.

Në lidhje me këtë çështje, sqarimi është dhënë në pikën 1.

5. Nga analiza e dokumentacionit të përcjellë si dhe raporteve të publikuara lidhur me blerjet e humbjeve në tregun e lirë, ku më e fundit është procedura e realizuar me datë 24.11.2021 për periudhën 1-31 dhjetor, të publikuar në faqen tuaj zyrtare, sasia e humbjeve në total ka rezultuar rreth 183 GWh, ndërkohë që parashikimi juaj për sasinë e humbjeve për Vitin 2021 është 234 GWh.

Nisur nga sa më lart, duhet të rikonsiderohen parashikimet tuaja lidhur me koston e blerjes së humbjeve jo vetëm për Vitin 2021, por dhe për periudhën 2022-2024

Në lidhje me këtë pikë, në materialet e dërguara në ERE, është bërë një analizë e realizimit dhe parashikimeve të bilancit energjetik për vitin 2021 (“Relacionin për llogaritjen e tarifave të transmetimit të energjisë elektrike për vitin 2022 dhe periudhën 2022-2024”-faqe 4-10 si dhe Shresa Nr. 5215/3 datë 04.11.2021 me materialet bashkelidhur). Duke ju referuar këtyre parashikimeve përsa i përket sasive të humbjeve në rrjetin e transmetimit dhe analizës së çmimeve të blerjes së tyre, janë pasqyruar dhe vleresimet mbi kostot e nevojshme për këtë zë shpenzimesh. Megjithatë, në vijim OST sqaron se:

Lidhur me parashikimin e humbjes së energjise në rrjet për vitin 2021, rezulton se në gjashtëmujorin e parë sasia e energjise se humbur është 134.751 GWh, me një rritje prej 45.688 GWh krahasuar me vitin 2020, ose 51.3%, kjo si rrjedhojë e punës në regjim eksporti por edhe nga rritja e konsumit. Në tremujorin e tretë humbja është 44.869 GWh, me një rritje prej 6.424 GWh, ose 16.7%, kjo si rrjedhojë e rritjes së kërkesës për energji elektrike. Me të njëjtën logjikë të trendit është bërë parashikimi i humbjes në tremujorin e katërt (53 GWh) me një rritje prej 8.31 GWh krahasuar me humbjen e regjistruar një vit më parë, dhe për të gjithë vitin rezulton shuma prej 234 GWh.

Tregu i energjisë elektrike gjatë vitit 2021 ka qënë i paqëndrueshëm dhe jo tipik, kriza e energjisë që ka përfshirë europën e më tej nuk duket të ketë premisa të ndryshojë në afat shkurtër. OST sh.a. i referohet Bursës rajonale për parashikimin e trendit të çmimit. Kjo krizë, gjithashtu ka ndikuar në pjesëmarrjen e tregtarvë të energjisë në procedurat e zhvilluara nga OST sh.a. për blerjen e energjisë elektrike për nevojat e sistemit, për rrjedhojë, kërkesa e OST nuk është plotësuar e gjitha në këto procedura.

6. *Lidhur me parashikimet e kërkesës për sasinë e energjisë elektrike që pritet të lëvrohet në rrjetin e transmetimit për Vitin 2022 si dhe për periudhën rregullatore 2022-2024 paraqisni komunikimet dhe rakordimet me përdoruesit e fjetit të transmetimit (FTL sh.a., FSHU sh.a., OSSH sh.a. dhe Klientët e Kualifikuar).*

Ne lidhje me këtë çështje, vlerësimet dhe analizat e nevojshme për kërkesën dhe bilancin energjetik, janë pasqyruar tashme në korrespondencat e mëparshme (*“Relacionin për llogaritjen e tarifave të transmetimit të energjisë elektrike për vitin 2022 dhe periudhën 2022-2024”-faqe 4-10 si dhe Shresa Nr. 5215/3 datë 04.11.2021 me materialet bashkelidhur*).

Megjithatë sërisht OST sh.a. ju konfirmon se ka komunikuar me Përdoruesit e rrjetit dhe pjesëmarrësit e tregut të energjisë elektrike lidhur me parashikimet e kërkesës për sasinë e energjisë elektrike që pritet të lëvrohet në rrjetin e transmetimit për vitin 2022 si dhe për periudhën rregullatore 2022-2024. Përsa i përket rakordimeve me (FTL,sh.a, FSHU sh.a) pjesë e OSHEE Group, OST ka komunikuar me FTL sh.a. si lider i grupit balancues (bashkelidhur shkresa), i cili ka përcjellë informacion të detajuar mbi sasinë e konsumit dhe gjenerimit të energjisë elektrike që do të konsumohet/gjenerohet nga OSHEE Group.

Informacion mbi konsumin e energjisë elektrike kanë përcjellë në OST edhe disa konsumator të kualifikuar të lidhur direkt në sistemin e Transmetimit ( bashkelidhur gjeni korespondencën)

Është e rëndësishme të theksohet se, lidhur me parashikimet e kërkesës për sasinë e energjisë elektrike që pritet të lëvrohet në rrjetin e transmetimit për vitin 2022 si dhe për periudhën rregullatore 2022-2024, OST sh.a është bazuar edhe në të dhënat historike, eksperiencën shumë vjecare duke konsideruar rritjen e mundshme të numrit dhe volumit të kërkesës së Konsumatorëve të Kualifikuar.

7. *Lidhur me "Menaxhimin e kongjestionit me ridispecerim", i cili si cituar nga ana juaj është kthyer në detyrim për OST prej datës 01.04.2021 me hyrjen në fuqi të Rregullave të Tregut Shqiptar të Balancimit të Energjisë Elektrike, paraqisni analizat tuaja për parashikimin e këtij shpenzimi duke e krahasuar me kapacitetin e përdorur në periudhat e mëparshme ushtrimore si realizim faktik nëse ka patur si dhe referencat e përdorura mbi çmimet e parashikuara për realizimin e tij në periudhën e ardhshme rregullatore 2022 - 2024.*

Ne lidhje me këtë çështje, vlerësimet dhe analizat e nevojshme, janë pasqyruar tashme në mënyrë analitike në korrespondencat e mëparshme (*“Relacionin për llogaritjen e tarifave të transmetimit të energjisë elektrike për vitin 2022 dhe periudhën 2022-2024”-faqe 41 si dhe Shresa Nr. 5215/3 datë 04.11.2021 me materialet bashkelidhur*).

Megjithatë OST sqaron se: Në zbatim të dispozitave të Kodit të Transmetimit, neni 132, pika 1, gërma a) dhe b) është përgjegjëse për sigurinë operationale në zonën e vet të përgjegjesisë në aspektin e:

- a) Përdorimit të mjeteve brenda zonës së vet të përgjegjësive, duke përfshirë operimin në kohë reale, planifikimin operacional, zhvillimin dhe shpërndarjen e aseteve dhe dhënien e zgjidhjeve për parandalimin dhe riparimin e defekteve;
- b) Përdorimit të mjeteve të mundësuar përmes bashkëpunimit me palët e tjera të interesit, duke përfshirë këtu ri-dispeçimin ose ri-skedulimin dhe menaxhimin e kongjestionëve, rezervave operative dhe shërbimeve të tjera ndihmëse;

Përsa më lartë OSTsh.a mund ta aplikonte ri-dispeçimin e energjisë elektrike nga centralët prodhuese në funksion të sigurisë së punës së Sistemit dhe sigurisë së furnizimit, pa ndikuar në detyrimet kontraktore të furnizimit me energji elektrike dhe pa detyrime financiare.

Hyrja në fuqi me Vendimin Nr 106 /2020 ERE të “Rregullave të Tregut Shqiptar të Balancimit të Energjisë Elektrike” nuk i le më hapsira OST ta kërkojë këtë shërbim të përdoruesit të rrjetit, në funksion të sigurisë së punës së Sistemit dhe sigurisë së furnizimit pa shlyer detyrimet financiare për shërbimin e kërkuar nga OST dhe të ofruar nga përdoruesit. Jo vetëm vendimi 106 i EREs por edhe Ligji 43/2015 (i perditesuar) neni 51, pika 1, germa b) citohen se: Prodhuesit kanë të drejtë: të shesin energjinë elektrike dhe të sigurojnë shërbimet ndihmëse dhe të balancimit në tregun e energjisë elektrike, në përputhje me rregullat e tregut dhe rregulloret e tjera të ERE-s dhe në pikën 2, pika c të nenit 51 citohet se Prodhuesit kanë detyrim: të sigurojnë shërbime ndihmëse ndaj operatorit të sistemit në përputhje me rregullat e tregut;

Përsa i përket kapaciteteve të përdorura në periudhat e mëparshme ushtrimore si realizim faktik, ju bejme me dije se OST sh.a nuk ka raste të mëparshme për Menaxhimin e kongjestionit me ridispeçim.

Analiza për parashikimin e këtij shpenzimi është realizuar bazuar në të dhëna teknike dhe eksperiencën shumë vjeçare të operimit të sistemit dhe si rrjedhojë është vlerësuar se:

Për përmasat e Sistemit tonë është vlerësuar i mjaftueshëm kapaciteti prej 100 MW. Numri i ditëve potencialisht të mundëshme për aplikimin e ridispeçimit janë përlllogaritur 100 ditë, dhe me një kohëzgjatje të mundëshme prej 6 orë, për çdo rast ridispeçimi

8. *Lidhur me "shpenzimet për shërbimet ndihmëse" konstatohet se realizimi faktik për periudhën janar-shator 2021 ka qënë në vlerën 621 milion lekë, dhe pritshmëria juaj për Vitin 2021 është në vlerën 846 milion lekë. Ndërkohë për periudhën e ardhshme rregullatore ky shpenzim është parashikuar të jetë respektivisht për Vitin 2022 në vlerën 1,708 milion lekë, për Vitin 2023 në vlerën 1,924 dhe për Vitin 2024 në vlerën 2050 milion lekë. Sa më sipër meqënëse ky shpenzim parashikohet të realizohet me një rritje të konsiderueshme jo vetëm për Vitin 2022 por për të gjithë periudhën pasardhëse rregullatore duhet të dërgohen argumentat dhe analizat tuaja mbi parashikimin e tij duke dërguar dhe evidencat mbi kapacitetin e përdorur në periudhat e mëparshme ushtrimore krahas kapacitetit të parashikuar për tu përdorur në periudhën rregullatore të propozuar.*

Ne lidhje me këtë çështje, vlerësimet dhe analizat e nevojshme, janë pasqyruar tashme në mënyrë analitike në korrespondencat e mëparshme (“Relacionin për llogaritjen e tarifave të transmetimit të energjisë elektrike për vitin 2022 dhe periudhën 2022-2024”-faqe 43 si dhe Shresa Nr. 5215/3 datë 04.11.2021 me materialet bashkelidhur).

Angazhimi i burimeve për të mbajtur frekuencën e rrjetit në nivelin e pranueshëm, organizohet nëpërmjet katër produkteve balancuese FRC,aFRR,mFRR,RR. (shërbime ndihmëse).

Sa i takon vitit 2021, para operimit të Tregut Shqiptar të Balancimit nga Prilli 2021, këto shërbime për tremujorin e parë të vitit janë ofruar me një çmim të rregulluar shumë më poshtë se tregu.

Në lidhje me shpenzimet për shërbimet ndihmëse, në forma analitike gjeni me poshtë parashikimin për periudhën 2022-2024:

Per periudhën Janar - Dhjetor, viti 2022

Nr	Ora	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	13	14	15	16	17	18	19	20	21	22	23	24	Σ	
1	FCR+	8	8	8	8	8	8	8	8	8	8	8	8	8	8	8	8	8	8	8	8	8	8	8	8	8	192
2	FCR-	8	8	8	8	8	8	8	8	8	8	8	8	8	8	8	8	8	8	8	8	8	8	8	8	8	192
3	aFRR+	25	25	25	25	35	35	40	40	40	40	40	40	40	40	40	40	50	50	50	50	50	50	50	50	40	960
4	aFRR-	40	40	40	40	40	40	40	40	40	30	30	30	30	30	30	30	30	30	30	30	30	30	30	40	40	830
5	mFRR+	75	75	75	75	75	75	75	75	75	75	75	75	75	75	75	75	75	75	75	75	75	75	75	75	75	1800
6	mFRR-	25	25	25	25	25	25	25	25	25	25	25	25	25	25	25	25	25	25	25	25	25	25	25	25	25	600
7	Total	181	181	181	181	191	191	196	196	186	186	186	186	186	186	186	186	196	196	196	196	196	206	206	196	4574	

Per periudhën Janar - Dhjetor, viti 2023

Nr	Ora	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	13	14	15	16	17	18	19	20	21	22	23	24	Σ	
1	FCR+	9	9	9	9	9	9	9	9	9	9	9	9	9	9	9	9	9	9	9	9	9	9	9	9	9	216
2	FCR-	9	9	9	9	9	9	9	9	9	9	9	9	9	9	9	9	9	9	9	9	9	9	9	9	9	216
3	aFRR+	30	30	30	30	40	40	50	50	50	50	50	50	50	50	60	60	60	60	60	70	70	60	60	40	1190	
4	aFRR-	45	45	45	45	45	45	45	45	40	40	40	40	40	40	40	40	40	40	30	30	30	40	40	40	40	970
5	mFRR+	75	75	75	75	75	75	75	75	75	75	75	75	75	75	75	75	75	75	75	75	75	75	75	75	75	1800
6	mFRR-	25	25	25	25	25	25	25	25	25	25	25	25	25	25	25	25	25	25	25	25	25	25	25	25	25	600
7	Total	193	193	193	193	203	203	213	213	208	208	208	208	208	208	218	218	218	218	218	218	218	218	218	198	4992	

Per periudhën Janar - Dhjetor, viti 2024

Nr	Ora	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	13	14	15	16	17	18	19	20	21	22	23	24	Σ	
1	FCR+	10	10	10	10	10	10	10	10	10	10	10	10	10	10	10	10	10	10	10	10	10	10	10	10	10	240
2	FCR-	10	10	10	10	10	10	10	10	10	10	10	10	10	10	10	10	10	10	10	10	10	10	10	10	10	240
3	aFRR+	40	40	40	40	40	45	50	50	50	50	50	50	50	55	60	60	60	60	70	80	80	70	70	60	1310	
4	aFRR-	50	50	50	50	50	50	50	50	50	50	50	50	50	40	40	40	40	40	30	30	30	40	45	45	1070	
5	mFRR+	75	75	75	75	75	75	75	75	75	75	75	75	75	75	75	75	75	75	75	75	75	75	75	75	1800	
6	mFRR-	25	25	25	25	25	25	25	25	25	25	25	25	25	25	25	25	25	25	25	25	25	25	25	25	25	600
7	Total	210	210	210	210	210	215	220	220	220	220	220	220	220	210	215	220	220	220	220	230	230	230	235	225	5260	

Në tabelat e parashikimeve, mund të vihet re se OST sh.a. në dallim nga vitet e mëparshme për vitin 2022 e në vijim ka parashikuar prokurimin e rezervës për mbajtjen e frekuencës FCR në të dy drejtimet, fakt i cili shkakton një rritje të shpenzimeve për zerin e rezervave për shërbimet ndihmëse. Kapaciteti i Rezervës së Mbajtjes së Frekuencës (FCR), njohur gjithashtu si rezervat e rregullimit primar, nuk llogaritet nga OST. Kjo rezerve perlllogaritet për sistemin tone energjistik dhe të gjitha OST-të e zones sinkrone europiane ku OST bën pjesë nga ENTSO-E, sipas nje Modeli Probabilistik Simulimi i cili është në gjendje të llogarisë sasinë minimale të FCR-së së nevojshme si kontribut i cdo OST-je, për të ruajtur frekuencën në gjendje të qëndrueshme brenda devijimit maksimal të frekuencës në gjendje të qëndrueshme për të gjithë zonën sinkrone.

Nga tabelat mund të konstatohet lehtësisht një rritje e kapacitetit rezerve aFRR periudhën 2022-2024. Rritja e kapacitetit rezervë për aFRR, vjen si pasojë e detyrimit që ka OST për mbajtjen e balances së SEE, me devijime minimale. Duke pasur në konsideratë natyrën e devijimeve, ndikuar dhe nga zhvillimi burimeve të rinovueshme dhe integrimin e tyre në SEE, është e domosdoshme rritja e kapacitetit rezervë për përbalimin e devijimeve, të shkaktuara nga ndryshueshmëria e prodhimit të energjisë elektrike nga burimet e vogla hidro/solar që priten në lidhjen në SEE.

- Lidhur me raportin e borxhit dhe kapitalit konstatohen ndryshime në parashikimet tuaja për realizimin e tij nga aplikimi fillestar me nr prot 5215 dt 31.08.2021, krahasuar me të dhënat e përditësuar dhe të përcjella me shkresën me nr prot 5215/3 datë 04.11.2021. Nga analiza e pasqyrave financiare të vitit 2020, konstatohet se raporti borxh-kapitali vet për Vitin bazë 2020 është paraqitur në vlera pothuajse të përmbytura dhe jo mbështetur në përcaktimet e metodologjisë së tarifave të transmetimit të energjisë elektrike, jo vetëm për mbylljen e vitit 2021 por gjithashtu dhe për periudhën rregullatore të propozuar. Sa më sipër duhet të paraqiten argumentat bashkë me analizat tuaja të cilat kanë shërbyer për paraqitjen e këtyre treguesve në këtë formë si dhe për ndryshimet e tyre nga aplikimi fillestar me atë të përditësuar së fundmi.

Në vijim të sa më sipër duhet të përcillen në ERE të dhënat të shoqëruara me argumenta dhe analizat përkatëse lidhur me përllogaritjen e komponentit të kthimit të kapitalit por dhe të kostos së borxhit për periudhën rregullatore 2022 - 2024.

Plotësoni sipas tabelës me poshtë të dhënat mbi huamarrjet për vitin 2021 si dhe që parashikoni të likujdoni për periudhën 2022-2024:

Në lidhje me këtë çështje, në tabelën e mëposhtme paraqiten në mënyrë të detajuar, përllogaritjet e raportit të kapitalit të vet dhe borxhit si dhe përllogaritjet e kostos së borxhit, të cilat janë marrë për bazë në aplikimin për tarifën e transmetimit, në mbështetje të metodologjisë përkatëse:

	2020	2021	2022	2023	2024
<b>I. Raporti Borxhit dhe kapitalit</b>					
a. Detyrime afatgjata (ne fillim te vitit mln leke)	20,087	18,702	19,053	21,364	21,519
b. Kapitali (fillim te vitit mln leke)	31,766	32,453	31,277	32,516	33,826
<b>c Detyrime afatgjata+capital (mln leke)</b>	<b>51,853</b>	<b>51,154</b>	<b>50,330</b>	<b>53,880</b>	<b>55,345</b>
<b>Raporti borxhit (a/c %)</b>	<b>38.7%</b>	<b>36.6%</b>	<b>37.9%</b>	<b>39.7%</b>	<b>38.9%</b>
<b>Raporti kapitalit (b/c %)</b>	<b>61.3%</b>	<b>63.4%</b>	<b>62.1%</b>	<b>60.3%</b>	<b>61.1%</b>
<b>II. Kosto mesatare e borxhit</b>					
d. Interes i Viti baze (mln leke)	625	560	616	661	680
e. Huate (detyrimi ne fillim te vitit mln leke)	17,325	15,869	16,661	18,973	19,127
<b>CoD - Kosto e borxhit</b>	<b>3.61%</b>	<b>3.53%</b>	<b>3.70%</b>	<b>3.48%</b>	<b>3.55%</b>

Ne lidhje me vlerësimet dhe analizat e nevojshme për huatë, të gjitha të dhënat e detajuara për huatë, janë pasqyruar tashme në mënyrë analitike në materialet e derguara me tonën Nr. 5215/3 datë 04.11.2021, konkretisht në file: "Informacion per huate per ERE".

10. Duhet të dërgohen në ERE faturat respektive të transmetimit të energjisë elektrike për llogari të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes, Furnizuesit të Tregut të Lirë, Furnizuesit të Shërbimit Universal si dhe klientëve të kualifikuar për vitin 2020 dhe për periudhën Janar - Tetor 2021.

Ne lidhje me këtë çështje, bashkëlidhur do të gjeni informacionin e kërkuar.

11. Lidhur me bazën e rregulluar të aseteve, duhet të dërgohen në ERE në formate tabelare listat e aseteve sipas kostos historike dhe jo të rivlerësuar duke evidentuar shtesat përkatëse për çdo grup aseti mbështetur në planet e investimeve të miratuara nga ERE si dhe vlerat e amortizimit përkatës për periudhën 2015 2020 dhe pritshmërinë tuaj për vitin 2021. Gjithashtu duhet të përcillen në ERE në të njëjtin format baza e aseteve e parashikuar për periudhën 2022-2024. Risjellim ne vemendjen tuaj se duhet të dërgohet në ERE plani i përditësuar i investimeve për periudhën rregullatore 2022-2024 si një aplikim më vete në zbatim të përcaktimeve të pikës 5, nenit 60, të ligjit nr. 43/2015 "Për sektorin e energjisë elektrike" i ndryshuar, dhe kërkesave të "Rregullores së Procedurave të Paraqitjes dhe Miratimit të Planit të Investimeve" e miratuar me vendimin nr. 135/2017 të Bordit të ERE-s, ku çdo investim i parashikuar duhet të shoqërohet me relacione shpjeguese dhe studimet e fizibilitetit e më e rëndësishmja Analiza kosto përfitim, në mënyrë që të evidentohet dhe analizohet përfitimi ekonomik, financiar dhe teknik që këto investime pritet të sjellin për OST sh.a. në periudhën pasardhëse rregullatore.

Përsa i përket bazës së rregulluar të aseteve, bashkëlidhur do të gjeni në formate tabelare listat e aseteve sipas kostos historike.

Plani i investimeve për periudhën rregullatore 2022-2024 është dërguar si një pjesë e nevojshme integrale për hartimin e dokumentit të tarifës së transmetimit për vitin 2022 dhe periudhën rregullatore 2022-2024 sipas metodologjisë përkatëse.

Paraqitja formale e kërkesës për miratimin e Planit të Investimeve për periudhën rregullatore 2022-2024, do të bëhet pasi të jetë miratuar Programi i Zhvillimit Ekonomik të OST sh.a. për vitin 2022 jo vetëm nga Këshilli Mbikqyrës i OST por dhe nga MFE siç pasqyrohet dhe në nenin 10 pika 6 e “Rregullores së Procedurave të Paraqitjes dhe Miratimit të Planit të Investimeve”, hartimi dhe miratimi i të cilit është i lidhur me ecurinë e procesit të miratimit të tarifës së transmetimit për vitin 2022.

Përsa i takon ndryshimeve në zërat e shpenzimeve, në shkresën Nr. 5215/3, datë 04.11.2021 “Përgjigje shkresës Nr.914/2, datë 11.10.2021 “Mbi aplikimin e paraqitur nga shoqëria OST sh.a. me shkresën Nr.5215 Prot, datë 31.08.2021””, sipas kërkesave nga na e ERE, është bërë gjithë përditësimi i të dhënave në lidhje me kërkesat e Metodologjisë së llogaritjes së tarifave të transmetimit.

Mbetemi në dispozicion për çdo sqarim të mëtejshëm

Duke ju Falenderuar,

Me respekt,

**ADMINISTRATORI I OST sh.a.**



**Skerdi Drenova**